

VENDIM
Nr.192, datë 25.5.1990

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.93, DATË
23.3.1962 “PËR PËRMIRËSIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS SË SIGURIMEVE
SHOQËRORE SHTETËRORE DHE PËRCAKTIMIN E PËRQINDJES QË DUHET
DERDHUR NË DOBI TË TYRE”**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.93, datë 23.3.1962, pika 21 ndryshohet si vijon:

“Ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat shoqërore të derdhen në dobi të sigurimeve shoqërore shtetërore 21 për qind mbi fondin e pagave të punonjësve të tyre. Ky rregull të zbatohet edhe për punonjësit në organikë të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 1991.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI